REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KRYETARI I BASHKISË

Nr.3778 Prot Maliq, më 17.6.2026

PROJEKT-VENDIM - NR. 10

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.73 DATË 29.05.2026 PËR "FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHPRONËSIMIT PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE PRIVATE QË PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT "PALLATI I KULTURËS "DHIMITËR ORGOCKA"

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenin 9, pika 1.2 gërma b dhe c, nenit 23, pika 7, nenin 54, nenin 55 pika 2 dhe 6 të Ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, Ligjit Nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik", i ndryshuar, projektit të hartuar nga Sektori i Hartimit dhe Implementimit të Projekteve dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë, për objektin "Pallati i Kulturës "Dhimitër Orgocka"

PROPOZOJMË:

1. Fillimin e proçedurave të shpronësimit për interes publik të pasurive private që preken nga zbatimi i projektit "Pallati i Kulturës "Dhimitër Orgocka", sipas listës së pasurive, planeve të rilevimit dhe projektit që i bashkëlidhen këtij projekt-vendimi, si më poshtë:
   - Pasuria Nr.1/209, e ndodhur në Zonën Kadastrale 2573, me sipërfaqe 300 m^2.
   - Pasuria Nr.1/51, e ndodhur në Zonën Kadastrale 2573, me sipërfaqe 530 m^2.
2. Sektori i Pronave Publike dhe Aseteve, të kryeje verifikimet e dokumentacionit ligjor (statusit juridik) pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, të pasurive që preken nga zbatimi i projektit, si dhe të vijojë procedurat e metejshme të përgatitjes së dokumentacionit të plotë që nevojitet për shpronësim për interes publik dhe dërgimin e kërkesës zyrtare pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësim, Tiranë.
3. Për zbatim ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Pronave Publike dhe Aseteve pranë Bashkisë Maliq.

Konceptoi: J. Thomo Dt. 17/6/2026

Drejtor D.P.P.A: J. Sulo Dt. 17/6/2026

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KRYETARI

3778

Maliq, më 17.6.2026

Lënda: Relacion për fillimin e procedurave të shpronësimit për interes publik të pasurive private që preken nga zbatimi i projektit "Pallati i Kulturës Dhimitër Orgocka

Drejtuar: **Këshillit të Bashkisë Maliq**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenin 9, pika 1.2 gërma b dhe c, nenit 23, pika 7, nenin 54, nenin 55 pika 2 dhe 6 të Ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, Ligjit Nr. 8561 datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik", i ndryshuar, projektit të hartuar nga Sektori i Hartimit dhe Implementimit të Projekteve dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë, për objektin "Pallati i Kulturës "Dhimitër Orgocka".

Pasuritë të cilat preken nga shpronësim sipas kartelave të pasurisë janë:

- Pasuria Nr.1/209, e ndodhur në Zonën Kadastrale 2573, me sipërfaqe 300 m^2.
- Pasuria Nr.1/51, e ndodhur në Zonën Kadastrale 2573, me sipërfaqe 530 m^2.

Pasuritë e mësipërme ju përkasin:

- Jeta Mustafa Çeno me pjesë takuse 8/16
- Muhamere Agolli me pjesë takuse 4/16
- Republike Agolli me pjesë takuse 1/16
- Leonart Agolli me pjesë takuse 1/16
- Arjan Agolli me pjesë takuse 1/16
- Alma Agolli me pjesë takuse 1/16

Ky projekt-vendim ka për qëllim fillimin e procedurave të shpronësimit për interes publik të pasurive private që preken nga zbatimi i projektit "Pallati i Kulturës Dhimitër Orgocka". Realizimi i këtij projekti është në funksion të përmirësimit të infrastrukturës kulturore dhe rritjes së shërbimeve publike për komunitetin.

- Objekti "Pallati i Kulturës Dhimitër Orgocka" paraqet një rëndësi të veçantë publike dhe kulturore për Bashkinë Maliq, i cili do të shërbejë jo vetëm si qendër kulturore, por edhe si qendër komunitare për zhvillimin e aktiviteteve sociale, kulturore, artistike dhe edukuese

për qytetarët e Bashkisë Maliq. Realizimi i këtij projekti synon krijimin e një hapësire funksionale në shërbim të komunitetit, rinisë dhe organizimeve publike, duke ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e jetës kulturore dhe sociale në zonë.
Pasuria Nr.1/209, e ndodhur në Zonën Kadastrale 2573, me sipërfaqe 300 $m^{2,}$ është pjesë përbërëse e Gjimnazit Maliq (ambjent sportiv).

Për sa më sipër, në kompetencën tuaj ligjore, kërkojmë miratimin e projekt-vendimit të paraqitur, dhe ndjekjen më pas nga Drejtoria e Pronave Publike dhe Aseteve pranë Bashkisë Maliq, të procedurave të mëtejshme.

Konceptoi: J. Thomo Dt. 17 / 6 /2026

Drejtor D.P.P.A: J. Sulo Dt. 17 / 6 /2026

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ